



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2145/1 prot.

Tiranë më 14.10.2024

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 6307/10 prot., datë 01.10.2024, protokolluar me tonën me nr.2145 prot., datë 02.10.2024, me anë të të cilës dërgoni për mendim projektvendimin për miratimin në parim të “*Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar*” së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të sipërcituar, konstatohet përpunimi dhe transferimi i të dhënave personale si dhe respektimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në nenin 16 të projektvendimit janë përcaktuar rregullat në lidhje me përpunimin dhe trajtimin e të dhënave personale, duke i’u nënshtruar ligjeve të brendshme të palëve kontraktuese si dhe parimet kryesore të përpunimit të të dhënave nga autoritetet kompetente të palëve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”) dhe Vendimit nr. 8 datë 31.10.2016 të Komisionerit, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” Republika e Kazakistanit konsiderohet shtet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi nuk bën pjesë në listë.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se procesi i shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve ndërmjet palëve, legjitimohet duke plotësuar njërin nga kriteret e përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të Ligjit.

Për sa më lart, duke qenë se projektvendimi parashikon nënshkrimin e një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë si dhe në të janë referuar rregullat dhe parimet bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektvendimin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi